



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **19.08.2019**, me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes nënkryetarin **Fatmir Iska**, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim -Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik,**
3. **Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale,**
4. **Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit,**
5. **Të ndryshme.**

Pikat Shtesë

6. **Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Transparencë 2019,**
7. **Shqyrtimi i ndryshim - plotësimit të Statutit të Komunës së Rahovecit.**

Kryesuesi - Të nderuar anëtarë/e të KPF-së, para se t'ia filloj me rendin e ditës për mbledhjen e sotshme, po ju njoftoj se na është kthyer nga MAPL-ja për rishqyrtim të ligjshmërisë Rregullorja Komunale për Transparencë Nr.03/2019 ku është kërkuar që të bëhet harmonizimi I nenit 4.6 dhe 18. Po ashtu si pikë shtesë për mbledhje të kuvendit propozojmë që të kemi edhe një pikë e cila na ka ardhur nga Zyra e Kryetarit të Komunës që ka të bëjë me vulat e Kryetarit dhe vulat e Kuvendit, pra këtu duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i Statutit të komunës së Rahovecit. Të nderuar kuvendar a jeni të pajtimt që ti kemi këto dy pika shtesë për mbledhje të kuvendit. I vë në votim këto dy pika shtesë që i ceka më parë që të jenë si pika shtesë për mbledhje të kuvendit: Konsistoj se unanimisht janë aprovuar që pikat e lartcekura të jenë pjesë e mbledhjes së kuvendit. Tani të nderuar kuvendar e vë në votim rendin e ditës së bashku me pikat shtesë: Konstatoj se unanimisht është aprovuar rendit i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi - A ka dikush të shtojë diçka rreth procesverbalit, nëse nuk ka atëherë e vë në votim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës, për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik.

Artan Asllani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Kryetari i Komunës i propozon KPF-së miratimin e vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik, për zhvillimin e procedurave për ankandin publik dhe dhënien në shfrytëzim të hapësirave te depot e Matreksit të cilat gjenden në Xërxë. Për dhënien në shfrytëzim të kësaj hapësire, ne propozojmë që afati kohor të jetë prej 1 deri në 15 vite sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër. Pronat e paluajtshme për dhënien në shfrytëzim siç e cekem në pikën 1 të këtij propozimi janë zona kadastrale që gjenden në Xërxë, te depot e Matreksit dhe ne propozojmë për dhënien në shfrytëzim hapësirën prej 800m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit është të ruhet vlera e pronës si dhe të jepet në shfrytëzim personave të cilët dëshirojnë të zhvillojnë aktivitetet e tyre biznesore. Procedurat për dhënien në shfrytëzim shkojnë nëpërmjet ankandit publik dhe janë të gjitha procedurat e rregulluara sipas Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të kësaj hapësire caktohet në bazë të rregullores e cila është e përcaktuar me ligj. Për më shumë i kemi të bashkangjitur edhe kopjen e parcelës, çertifikatën.

Rasim Fazliu- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Pyetja ime për drejtorin është: Ky propozim-vendim që na keni sjellë sot këtu për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, a keni informata se deri tani kush e ka shfrytëzuar dhe a kemi të bëjmë me kalimin e afatit kohor të kontratës dhe tani kërkon që ti vazhdohet apo duhet edhe ai t'i nënshtrohet ankandit publik?

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I nderuari Kryesues, para se t'ia filloj diskutimin rreth kësaj pike desha ta bëjë një propozim lidhur me materialin për mbledhje sa i përket kopjeve fizike. Kësaj radhe ne kemi marr materialin edhe në kopje fizike si pjesë e KPF-së, mirëpo propozoj që edhe anëtarët tjerë të këtij komiteti të kenë kopje fizike, se paku ne anëtarët e KPF-së. Kështu që me këto dy kopje që do ti kemi do të plotësohet ai boshllëku, ne mendojmë se është e nevojshme karshi formës elektronike ta kemi edhe kopjen fizike së paku ne dy anëtarët e KPF-së. Sa i përket kësaj pike, ne mendojmë se z.Fazliu kërkoi disa sqarime, të njëjtët i kërkojmë edhe ne, natyrisht si herave tjera edhe kësaj here ne jemi që me ju dhënë në shfrytëzim prona e paluajtshme komunale bizneseve sepse është në interesin e dyanshëm. Është në interesin e komunës sepse krijon të hyrat vetanake, mirëpo në anën tjetër edhe bizneset përfitojnë. Natyrisht ceket aty që kjo duhet të bëhet konform ankandit publik pastaj përshkruhen edhe kriteret e caktuara e kështu me radhe, kështu që ne jemi pro që kjo pikë të kalojë për mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi- Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës.

Artan Asllani – Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara. I nderuar z. Fehmi Cena hapësira që po diskutohet sot nuk ka qenë asnjëherë në shfrytëzim, mirëpo ne e dimë se aty operojnë 5-6 kompani në atë hapësirë edhe gjysma prej tyre kanë edhe aneks kontrata. Janë disa biznese aty që kanë fituar edhe grand qeveritar vitin e kaluar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, mirëpo nuk po munden të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në zgjerimin e biznesit për shkak të mungesës së hapësirës. Atyre u ka mbetur inventari jashtë dhe nuk po kanë mundësi ta zhvillojnë aktivitetin e tyre, janë disa biznese nuk është vetëm një, që kanë bërë kërkesë për aneks kontrata për hapësirën e jashtme, kemi rastin e kompanisë Eurofood që i ka marr dy apo tre ankesa, mirëpo nuk do të thotë që kanë bërë aty kërkesë për shfrytëzim edhe ajo shkon me procedurë të ankandit publik, cili jep ofertën më të mirë.

Rasim Fazliu - Unë nuk jam jurist por desha të ndalem tek pika e parë, ndoshta na ndihmon edhe nënkryetari pasi është i atij profesioni, Kryetari i Komunës propozon komitetit për politikë dhe financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak. Çka do të thotë kjo i nderuar, ka ndonjë vendim paraprak dhe tani ne duhet me miratim atë vendim, mos është e formuluar gabimisht? Në qoftëse ka ndonjë vendim paraprak atëherë ne nuk kemi mundësi me marr vendim mbi vendim. Mirë është që ky vendim të shikohet edhe një herë nga zyrtarët ligjorë dhe të vijë i përmirësuar për mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit për diskutimin e bërë, konstatoj se Propozim -Vendimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik kalon për mbledhje të Kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Artan Asllani - Përshëndetje edhe njëherë, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale me numër 01 Nr.576, të datës: 28.02.2017, aktualisht jemi duke punuar me këtë

rregullore, mirëpo në bazë të punës që kemi bërë edhe në terren dhe në bazë të kërkesave të shumta që kemi pasur nga ana e bizneseve e kemi parë të arsyeshme të ju propozojmë juve anëtarëve të KPF-së dhe anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit ndryshimin e kësaj rregullore. Rregullorja zakonisht hyn një herë në vit mirëpo vitin e kaluar nuk kemi pas ndonjë ndryshim pos që është bërë një ndryshim i vogël në Drejtorinë e Financave edhe në shërbimet publike këtë vit. Ne e kemi parë të arsyeshme këtë vit të sjellim si propozim një ndryshim në kuadër të Drejtorisë së Ekonomisë po ashtu edhe një ndryshim në Drejtorinë e Shëndetësisë konkretisht të QPS-së. Siç e thash edhe më herët kam qenë në dijeni që ndërmarrjet prodhuese dhe përpunuese dhe bizneset e vogla nuk kanë qenë të ngarkuara në taksa, mirëpo gjatë punës kemi hasur që këto realisht e kanë një ngarkesë. Qëllimin ndoshta pse e kemi sjellë këtu, e kam marr edhe një model dhe besoj që një biznes i vogël nëse shikojmë në rregullore: ceket se biznes jo i specializuar e ka një kod mirëpo më herët para 2017 kanë qenë në emërtime, në rastin konkret ka qenë dyqan i pavarur tregtar e ku e di unë, mirëpo kur është aprovuar rregullorja në 2017 atëherë me kod ngarkesën dhe nëse shikon në rregullore duke analizuar që një biznes i vogël jo i specializuar e ka ngarkesën me 50.00 €, mirëpo unë kam marr edhe një shembull këtu. Po ashtu e kam parë të arsyeshme nëse edhe ju i përkrahni këto biznese, e kam bërë edhe një raport, i kemi marrë të gjitha informatat edhe në zyrat e ARDK-së ku regjistrohen bizneset edhe te zyrtari për taksa dhe tarifa. E kam parë të arsyeshme nëse edhe ju e përkrahni janë diku me shumë se 130 biznese, vlera e tyre në total në të hyra është afër 7,000.00 € vjetore, edhe ashtu bizneset e vogla janë të lodhura duke pasur parasysh konkurrencën madhe që ju bëhet nga bizneset e mëdha. Prandaj nëse i miratoni këto propozimet tona do ti ndihmoni shumë këtyre bizneseve. Po ashtu te tabela 17.5 tarifa për sektorin e QPS-së ka ardhur një propozim nga drejtori QPS-së për të bërë disa ndryshime, QPS-ja i ka dhënë disa arsyetime pse duhet të ndryshohen këto tarifa, të gjitha këto shërbime që kryhen, ndoshta kryhen deri sa të shfuqizohet ai ligj ose diçka tjetër.

Bilbil Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Të nderuar, ne si Qendër Sociale i kemi disa shërbime të cilat janë me pagesë, ato shërbime janë kryesisht shërbime që nuk kanë të bëjnë me raste sociale, do të thotë shërbimet që përjashtojnë rastet sociale. Në bazë të praktikës dhe përvojës edhe prej qendrave tjera sociale sidomos me qendrën sociale të Prizrenit, ku kemi marr orientim kryesor, kemi bërë propozim për ndryshimin dhe plotësimin e pagesave për shërbimet jo sociale. Këto shërbime janë kryesisht administrative por ka edhe të atilla që janë profesionale ku duhet të dalim edhe në teren, organi i kujdestarisë zakonisht krijon shpenzimet gjatë punës. Disa kategori faktikisht që kanë qenë 12 në rregulloren e pagesave, i kemi zvogëluar në 9 kategori apo 9 shërbime, që duhet të paguhen, ndërkohë për neve shumë ma me rëndësi është si qendër sociale ndryshimet në piken (a), propozimet 1 dhe 2, të lirohen nga pagesat e taksave komunale rastet sociale d.m.th shfrytëzues të ndihmave sociale. Një familje që vjen edhe aplikon për ndihmë sociale dhe duhet t'i nxjerrë për gjithë dokumentet personale si certifikatat e lindjes dhe dokumente tjera përcjellëse, për të gjitha këto paguajnë, do të thotë gjykatat dhe organet tjera asnjëherë nuk i paguajnë rastet sociale, ne disa here kemi bërë kërkesë por deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë. Propozimet tona se cilat taksa duhet të hiqen dhe cilat taksa duhet të ndryshohen, materialin e keni para vete, nëse doni mundem edhe të ju prezantoj me radhë, por besoj se nuk është e nevojshme.

Rasim Fazliu - Falënderojmë drejtorin z. Bilbil, për këto informata që na dha, për këto propozime mirëpo unë kam një pakënaqësi ose vërejtje shumë të madhe për shkak se këtu është bërë një përzierje sa që nuk kam mundur të kuptoj asgjë. Në njërin anë kemi njëfarë liste këtu prej 9 pikëve, ku janë të propozuar vetëm ngritjet ,drejtori doli dhe na i prezantoi edhe ato ku do të hiqen këto tarifa, shtrohet pyetja pse nuk na është servuar materiali neve si KPF ashtu siç duhet me të gjitha ato të dhëna që i paraqiti drejtori, në mënyrë që ne të kemi se çka të diskutojmë. Prandaj nuk e di pse ka ndodh kjo tollovi thjesht ta quaj apo jo, por si do qoftë ne jemi për atë që kjo pikë të na vije në kuvend, por jo kështu si na ka ardhur ne KPF, por të vije me propozime konkrete për të gjitha pikat, në mënyrë që në kuvend të jemi të përgatitur dhe në bazë të arsyeshmërisë që kemi me marr vendime të caktuara si kuvend i komunës së Rahovecit. Sa i përket pikës për armëmbajtje që e cila ka ngritje edhe unë jam pro që të ketë ngritje të taksës, mirëpo ligji është ai që e lejon, sepse ne jemi kundër asaj që me pas arme, por kjo duhet të jetë e ndaluar me ligj. Prandaj kjo është mirë sepse e rrit arkën e buxhetit të komunës mirëpo nuk ndikon në atë që ta marrish apo mos ta marrish armën, pra nuk e zbut atë problem. Kam një propozim konkret për mbledhje te kuvendit taksa për vërtetimin për punësim fillestar që është këtu prej 5 euro ne 10 euro, propozoj që të hiqet krejt kjo taksë, ku me marr na

njerëz që të punësojmë ose le të jetë simbolike 1 €, e jo të bëhet nga 5 € në 10 €. Njerëzit lodhen me konkurse ka 30 apo 40 për një vend pune dhe në fund një pranohet, për shkak se nuk ja lejon mundësia se një vend pune është, mirëpo nuk bën që në këtë aspekt të diskriminohen, pra me pagesa, ne kemi mundësi tjera me mbledhë ose me e rrit buxhetin e komunës, e jo të jetë kjo kategori e njerëzve.

Dervish Çadraku – Përshëndetje për gjithë të pranishmit! Po ashtu edhe unë jam për këtë pikë të rendit të ditës që mos të diskutohet sot sepse nuk e kemi materialin e mjaftueshëm dhe deri sa ne diskutojmë ne nuk e kemi materialin komplet, prandaj nuk mundemi me i dhënë mendimin e plotë në mënyrë që me qenë vendim i fuqishëm për kuvend. Prandaj mendoj që mos me zgjat shumë, kam edhe një pyetje, çka do të thotë vërtetimi i zotësisë, çfarë kuptimi ka sepse unë nuk e kam te qartë, si duket nuk është në përputhje me përmbajtjen e fjalisë këtu brenda d.m.th ku është përdor ajo zotësi që në shqip do të thotë me qenë i aftë, i zoti, që mendoj se nuk është adekuat për fjalën që është.

Fehmi Cena - Ne kemi përpara një propozim nga Kryetari Komunës për plotësim-ndryshimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, për dy nene për disa taksa që lidhen për dy nene, nenin 23 dhe nenin 17.5. Te neni 23 po kërkohet të lirohen nga taksat komunale bizneset kryesisht tregtare por edhe prodhuese, në të parën është prodhimi i verës nga rrushi e kështu me radhë. Unë mendoj se kur jemi te taksat, çështja e taksave është çështje shumë e ndjeshme, për arsye se përmes tyre komuna siguron të hyrat vetanake të cilat ne e dimë se sa janë të rëndësishme. Ato janë të rëndësishme për ne qytetaret sepse kur ka më shumë buxhet ka edhe me shume projekte, ka edhe me shumë përmirësim të mirëqenies së qytetarëve, përsëri ato hyjnë në shërbim të tyre dhe mendoj që kur merret iniciativa për ndryshimin e taksave, besoj që drejtoria natyrisht ka bërë analizë mirëpo nuk e di a ka bërë vërtet analizë të mjaftueshme dhe ne çka është bazuar sepse duhet të jenë edhe shumë kritere. A keni biseduar me këtë grup të interesit që hynë këtu, a ka qenë pakënaqësia e tyre apo si është puna, ju e keni vërtetuar se gjendja e tyre nuk është e mirë, ne jemi për që ti dilet në ndihmë bizneset natyrisht mirëpo bizneset mund të ndihmohen edhe në forma të tjera në forma të shumta nga ana e komunës. Tani drejtori e ceku shumë e përgjithshme të lirimi, të ekonomia e zhvillimit dhe turizmit, nëse të gjithë këta lirohen nga kjo shumë në zero, atëherë brenda vitit komuna nuk do të ketë të hyra rreth 7,000.00 €, nuk e di sa është e saktë kjo për arsye nëse p.sh ne i marrim podrumet e prodhimit të verës nga rrushi në qytet është goxha numër i madh sa e di unë. Nëse ata nuk janë të regjistruar ajo diçka tjetër por nëse i marrim numrin e përgjithshëm të podrumeve, nëse e din drejtori duhet me qenë goxha, dhe nëse ata shumëzohen me 500.00 € në vit atëherë nuk janë 7,000.00 €, por duhet të jenë me shumë. Sidoqoftë po them ne jemi që ti dilet në ndihmë bizneseve, mirëpo kjo duhet të shikohet pak më mirë, sa është e arsyeshme sepse është thikë me dy tehe, në njërin anë po ndihmohen bizneset mirëpo në anën tjetër po dëmtohet buxheti i komunës me të cilin buxhet përsëri mund të ndihmohen në forma të tjera bizneset në përgjithësi. Po mendoj që mirë është me i analizuar edhe më mirë pastaj do të shohim dhe do të shqyrtojmë më hollësisht në mbledhjen e kuvendit, ku edhe shumica do ta japin mendimin tyre dhe do të kemi qëndrimet tona përfundimtare. Kur jemi te tabela tjetër tek neni 17.5 nga QPS-ja, këto shërbimet që na i prezantoi drejtori i QPS-së, vërtet atë që foli drejtori ne nuk i kemi të gjitha ato çka tha, d.m.th lirim prej taksave, shërbimet që janë të liruara ne nuk i kemi në material, ne i kemi vetëm ato që kanë ngritje dhe ai ceki se shembull kanë marr rregulloren nga kuvendi komunal i Prizrenit, pra Prizreni paska bërë këto ngritje. Natyrisht tash duhet të shikohet se çdo komunë i ka specifikat e veta dhe unë besoj se drejtori, pra drejtoria atje, shërbimi që është i ka analizuar edhe duhet ti analizoj sigurisht këto ngritje që i kanë bërë sidomos nëse janë të arsyeshme ose nuk janë të arsyeshme, sa i përket taksës për vërtetim të zotësisë për punësimet fillestare duhet të shikohet që të mos dëmtohen, ata të cilët konkurrojnë për një vend pune sepse ne e dimë që për një vend pune konkurrojnë shumë njerëz dhe e dimë që është numër shumë i kufizuar për t'u pranuar, kështu që mos të dëmtohen njerëzit sidomos ata që janë fillestarë. Përndryshe të këto vërtetimet për punësime sa e di unë çdo kush që konkurron për një vend pune kërkon edhe certifikatën mjekësore prej mjekut, ata i detyrojnë edhe një pagese atje 18.00 €, institucionit shëndetësorë 1.00 €, i paguhet bankës do të thotë ata edhe kështu i nënshtrohen disa shpenzimeve shtese, duhet të kemi kujdes në këtë aspekt. Përndryshe të nderuar për mbledhjen e kuvendit duhet të kemi materialin e plotë në mënyrë që ta dimë se cilat taksa lirohen dhe cilët janë ato taksa që vërtet po ngritën, sidoqoftë gjithmonë duhet me pas parasysh edhe qytetarin por duhet me pas parasysh edhe të hyrat që krijohen nga këto biznese edhe shërbime që kryhen.

Bilbil Oruqi – Të nderuar e thash edhe më herët se QPS-ja është organ profesional sa i përket definicionit zotësia e veprimit do të thotë: konstatim, zotësia e veprimit është term ligjor ka të bëjë me shumica apo të gjithë kanë zotësinë e veprimit në aspekt juridik dhe në aspekt personal ka persona që ju hiqet zotësia e veprimit nga sëmundjet e ndryshme, nga të metat tjera personale shëndetësore. Doktorin tha në QKMF paguhet 18.00 € për të njëjtën punë për vërtetimin e zotësisë së veprimit. Ne e kryem punën njëjtë, mjeku në aspektin profesional që i takon atij, e jep certifikatën që personi i caktuar është në gjendje të mirë shëndetësore për me krye një punë të caktuar për një konkurs të caktuar. Ne japim në aspekt social zotësinë e veprimit në bashkëpunim me gjykatën, gjykata kur nuk e heq zotësinë e veprimit pa bërë konsulta zyrtarisht me QPS-në. Qysh e jep mjeku mendimin profesional ashtu e jep edhe QPS-ja.

Kryesuesi – Faleminderit për diskutimin e bërë, konstatoj se propozimi i Kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, kalon për mbledhje të Kuvendit. kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

4. Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë! Do të jem i shkurtër, është informatë mbi implementimin e planit për investime të hapësirave të hapura publike në komunën e Rahovecit, komuna ka një plan 5 vjeçar i bërë nga ekspertët së bashku me komunën këtë plan të implementimit. Pastaj kjo sipërfaqe është e përgjithshme, si dhe zonat e përfshirjes së hapësirave të hapura publike në këtë dokument që përfshihen: mirëmbajtjen e gjelbërimit të ulët të mesëm dhe të lartë, mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë, sipërfaqe të shtruara, mirëmbajtjen e hapësirave për parkim të automjeteve, mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Më herët ka qenë e veçantë bashkë me hapësirat publike ndërsa tani mirëmbajtja e ndriçimit publik është e veçantë si kontratë, pastaj mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore etj. Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të hapësirave të hapura publike do të thotë në qytetin e Rahovecit janë parqet, gjelbërimet, sheshet të gjitha këto të evidentuara në metra katror. Komuna e Rahovecit ka kontraktuar tre operator ekonomik që kanë kontratë për mirëmbajtjen e hapësirave publike, këtu janë të ndarë në tre lote, është e dhënë edhe vlera por edhe lokacionet, tashme emërtim lokacionesh nuk ka por kush është i interesuar mundemi edhe këtë me bë. Gjithsej janë 103 lokacione, vlera e këtyre kontratave në tre lote është 53.302.16 €, pastaj janë dhënë edhe synimet dhe objektivat specifike si sensibilizimi komunitetit për mirëmbajtjen e hapësirave publike, rigjallërimi i hapësirave të hapura publike duke e rritur sipërfaqet publike me parqe, drunjë dekorativ, hapësira të gjelberta e kështu me radhë. Kjo pikë do të kalojë edhe në seancën e kuvendit, drejtori i shërbimeve publike do të jep ndoshta informata më të hollësishme në seancën e kuvendit.

Rasim Fazliu - Falënderoj nënkryetarin për këtë informatë! Fillimisht më vjen mirë që në komunën tonë ka filluar edhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe është rritë numri i sipërfaqes dhe kujdesi është më i madh. Po mendoj që informata ndoshta nuk është e plotë tamam sa duhet, unë jam i interesuar ta dijë a ka lokalitete në komunën e Rahovecit që kanë vende ose sipërfaqe që nuk mirëmbahen, në të gjitha këto kategori që janë të cekura këtu edhe për pastrimin varrezave e dëshmorëve? I nderuar kryesues, është mirë që për mbledhje të kuvendit, të kemi një listë dhe të ceket se cilat lokalitete nuk janë të prekura nga dora e komunës në aspektin e mirëmbajtjes.

Fehmi Cena - Me këtë informatë ne po informohemi se në fakt qenka plani dhe projekti 5 vjeçar, do të thotë për mirëmbajtjen e hapësirave publike 2016/2021 dhe është i caktuar, diku ceket se në krahasim me vitin 2016 vlera që ka qenë 25.000 euro vjetore e pagesës, tani është dyfishuar dhe është 53.000.00 €. Natyrisht e kuptoj se pse ka ardhur deri te zgjerimi i hapësirave publike dhe mirë është, ne e përkrahim mirëmbajtjen e tyre sepse ajo është në shërbim të qytetarëve. Ajo që po me intereson paraprakisht është: A kanë qenë të ndara këto në tri lote sikurse tani që janë tri operatorë ekonomik, apo ka qenë vetëm një operator ekonomik, ajo çka ne kishim me kerku kur shijojmë se 53,000.00 € janë duke u shpenzuar, është që puna të kryhet me cilësi dhe jo vetëm të merret ashtu, kompania me marr për detyrë dhe mos me krye pastaj me përgjegjësi. Po kemi edhe kemi pas mjaft vërejtje edhe nga delegatët tjerë, në fakt hapësirat publike edhe nuk po mirëmbahen ashtu si duhet, kërkojmë që ato të mirëmbahen konform rregullave, konform atyre kriterëve që kanë qenë të shkruara besoj në ankand, se kjo është kryer përmes tenderit dhe ankandit. Nëse e cekim këtu mbjelljen e drunjëve dekorativ, vitin e kaluar janë mbjell mjaft drunjë dekorativ në komunën tonë dhe ne e

kemi përkrahur projektin por e kemi pas një vërejtje që ata drunjë dekorativ duhet të mirëmbahen. Këta drunjë nëse nuk ujiten atëherë ato do të thahen dhe krejt ai shpenzim, ai projekt do të shkojë huq, unë e di që kam marr një përgjigje këtu nga drejtori se kompania që e ka bërë mbjelljen ajo ka marr për detyrë për tri vite me u përkujdes për mirëmbajtjen, ndoshta është ashtu por sidoqoftë duhet të shikohet te mos shkojnë huq këto pemët dekorative sepse e di që kanë qenë mjaft të kushtueshme.

Dervish Qadraku - Në qoftëse e marrim lapsin edhe i përlllogarisim këto hapësira të gjelbëra që mirëmbahen nga komuna, nuk është keq sa i përket këtyre fjalëve që po shkruhen këtu por në terren nuk janë aq produktive këto shkrime, këtu sepse në terren kemi mungesë të mirëmbajtjes nga komuna. Po nisem nga fshati im, nuk e di a është prezent drejtori këtu që të na tregoj që edhe hapësirat e lira që janë në mesin e fshatit, janë si kratere d.m.th, nuk i ka mirëmbajt askush, nuk i ka rrafshu askush, nuk i pastron nga barishtet që ka aty dhe në fakt po del ajo fjala popullore që shqiptaret vetëm brenda oborrit të tyre interesohen. Nuk e di ndoshta në këtë projekt janë edhe këto sipërfaqe të fshatrave dhe qytetit që nuk ka investuar komuna asgjë së paku në mirëmbajtjen, kur i sheh hapësirat e gjelberta në disa vende të tjera që pak herë i frekuentojnë qytetarët ndërsa këto që ne i shohim përditë si të dalim nga dera e oborrit është si lloj xhungle në miniature dhe e dyta une mendoj se ka rëndësi shumë vendosja e koshave për mbeturinat sidomos rreth shkollave, Andej ka qarkullojnë nxënësit, po nisem gjithmonë nga ajo e afërmya p.sh në fshatin tim qarkullojnë nxënësit aty rruga kryesore është e mbushur plot me letra me mbeturina që hedhin fëmijët pa dashje apo me dashje. Nuk ka kosha edhe me deshtë me i hedhë, nëse nuk duan t'i hedhin në vende publike ata duhet t'i mbushin xhepat e veta deri sa të shkojnë tek shtëpitë, kështu që është mirë të vendosen nëpër vende ku frekuentohen nga njerëzit.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e bërë, konstatoj se Informatë mbi implementimin e Planit për investime në hapësirat e hapura publike në Komunën e Rahovecit, kalonë për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e radhës.

5. Rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Transparencë 2019.

Aziz Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ashtu si e potencuat ju, MAPL-ja na ka kthyer rregulloren e cila është aprovuar në mbledhjen e fundit të kuvendit, MAPL-ja na ka rekomanduar me harmonizuar me rregulloren me nr.01/2017 dhe udhëzimin administrativ 04/2018. Nenet që është dashur të harmonizohet kjo rregullore me këtë rregulloren tjetër dhe udhëzimin administrativ është neni 4, pika 4.6 që është në faqen 3. Unë e kam bërë të nënvizuar me hijezim të zi aty ajo që duhet të largohet dhe i kam vë edhe ka një vijë, faqen e 5-të neni 6, pika 6.9 të fundit e keni faqe 9, neni 18 dhe 18.1 dhe 18.2.

Kryesuesi- Faleminderit z. Krasniqi, a ka dikush diçka rreth kësaj pike? Konstatoj se rishqyrtimi i Rregullores Komunale për Transparencë Komunale kalon për Kuvend. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.


6. Shqyrtimi i ndryshim- plotësimit të Statutit të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të KPF-së vulat nga Zyra e Kryetarit dhe Kuvendit do të jenë vulat e veçanta, do të bëhet edhe plotësim-ndryshimi i statutit po në Kuvend. Nëse ka dikush të shtojë diçka sa i përket kësaj pike fjala është e juaja, nëse jo atëherë konstatoj se ndryshim- plotësimi i Statutit të Komunës së Rahovecit, kalon për mbledhje të Kuvendit. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

7. Të Ndryshme.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikës së fundit të mbledhjes, nëse jo mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:45

Procesmbajtësi,

Skender Hamza

